



# BULETIN MUJOR

TETOR 2024



## PËRMBAJTJA

- Zhvillohet Konferenca Kombëtare e Sigurisë Kibernetike
- Shqipëria mirëpret vizitën e parë zyrtare të Qendrës Evropiane për Ekselencë në Trajtimin e Kërcënimeve Hibride
- Vajzat Dhe Gratë Në Sigurinë Kibernetike: Workshop i Organizuar nga AKSK me mbështetjen e OSCE në Shqipëri
- AKSK dhe ERE – marrëveshje bashkëpunimi për mbrojtjen e infrastrukturës energjetike nga kërcënimet kibernetike
- Zhvillohet Trajnim me temë: “Metodat Alternative në Sigurinë Kibernetike me Platforma Open Source”
- Her Cyber Tracks: Fuqizimi i Grave në Sigurinë Kibernetike

## Zhvillohet Konferenca Kombëtare e Sigurisë Kibernetike, AKSK prezanton arritjet e Shqipërisë



AKSK organizoi Konferencën Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, duke mbledhur ekspertë të sigurisë, përfaqësues të sektorit publik dhe privat, anëtarë të kabinetit qeveritar dhe partnerë ndërkombëtarë për të diskutuar sfidat dhe strategjitë për mbrojtjen e hapësirës digjitale të Shqipërisë.

Panelet e konferencës trajtuan temat më aktuale si mbrojtja e infrastrukturave kritike, përmirësimi i sigurisë në sektorët e energjisë dhe financave, si dhe përfitimet e Shqipërisë nga adoptimi i direktivës NIS2.

## Shqipëria mirëpret vizitën e parë zyrtare të Qendrës Evropiane për Ekselencë në Trajtimin e Kërcënimeve Hibride

Më 22 tetor 2024, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike mirëpriti përfaqësuesit e Qendrës Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride në vizitën e tyre të parë zyrtare në Shqipëri, pas anëtarësimit të vendit tonë më 13 qershor 2024. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i përvojave për përballimin e kërcënimeve hibride, si dezinformimi dhe ndërhyrjet kibernetike, duke forcuar mbrojtjen kombëtare. Drejtori i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e talenteve të reja në fushën e sigurisë kibernetike.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



[www.aksk.gov.al](http://www.aksk.gov.al)



[@aksk.gov.al](https://www.instagram.com/aksk.gov.al)



+355 422 21 039





## Vajzat dhe Gratë në Sigurinë Kibernetike: Workshop i organizuara nga AKSK me mbështetjen e OSCE në Shqipëri

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, me mbështetje nga OSCE, organizoi një workshop për fuqizimin e grave dhe vajzave në fushën e sigurisë kibernetike, duke ofruar hapësirë për ndarjen e përvojave dhe zhvillimin e aftësive praktike. Drejtori i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e nxitjes së vajzave drejt kësaj fushe dhe rolin e pazëvendësueshëm të grave në ofrimin e një perspektive të gjerë për zgjidhjen e sfidave të sigurisë kibernetike. Workshop-i përfshinte gjithashtu një panel diskutimi me gra të suksesshme dhe një cyber drill, ku pjesëmarrësit ushtruan aftësitë e tyre në skenarë realë.

## AKSK & ERE, marrëveshje bashkëpunimi për mbrojtjen e infrastrukturës energjetike nga kërcënimet kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) dhe Enti Rregullator i Energjisë (ERE) nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për të përmirësuar sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë. Ky partneritet synon krijimin e një sistemi mbrojtës të fuqishëm, duke lehtësuar shkëmbimin e informacionit në kohë reale dhe ndarjen e indikatorëve të kompromisit për parandalimin e sulmeve. Përmes kësaj marrëveshjeje, do të organizohen trajnime dhe seminare për rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë kibernetike, duke kontribuar në një sektor energjetik më të mbrojtur.



## Zhvillohet Trajnim me temë: "Metodat Alternative në Sigurinë Kibernetike me Platforma Open Source"

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi një trajnim për stafin e infrastrukturave kritike dhe institucioneve të pavarura, me fokus në rritjen e kapaciteteve teknike përmes teknologjive open-source në mbrojtjen kibernetike. Trajnimi shkon përtej simulimeve të zakonshme, duke ofruar mënyra praktike për implementimin e mjeteve open-source për mbrojtjen e rrjeteve dhe sistemeve. Qëllimi ishte fuqizimi i institucioneve me një mbrojtje kibernetike të qëndrueshme dhe efektive, duke ofruar zgjidhje alternative përballë buxheteve të kufizuara.

## Her Cyber Tracks: Fuqizimi i Grave në Sigurinë Kibernetike

U zhvillua për herë të parë në Tiranë "Her Cyber Tracks," një event ndërkombëtar i organizuar nga ITU, GIZ dhe UNODC, i cili synon të promovojë liderhipin e vajzave dhe grave në fushën e sigurisë kibernetike. Drejtori i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e përfshirjes së grave dhe domosdoshmërinë e krijimit të mundësive për të thyer barrierat që pengojnë avancimin e tyre. Pjesëmarrësit patën gjithashtu mundësinë të vizitojnë ambientet e AKSK për të mësuar rreth strukturave dhe punës për mbrojtjen e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.

